

VENDIM
Nr. 177, datë 18.5.2023

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 13 dhe 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1011/1 prot., datë 17.5.2023, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 104, datë 20.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar, duke shtuar në këtë licencë dhe HEC “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw dhe kapacitet total të instaluar 14 962 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit në Bashkinë Mat, qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, qarku Lezhë.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.3.2023 dhe 23.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.4.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1011/5 prot., datë 3.3.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k. për këtë vendim dhe i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., duke i kërkuar të shprehin komentet apo opinionet e tyre, në lidhje me këtë procedurë, në rast se kanë të tilla.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1011/6 prot., datë 5.4.2023, AMBU-ja ka shprehur dakordësinë e saj, në lidhje me vendimmarrjen e ERE-s.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon: Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”: plotësuar.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj pagesave të rregullimit ndaj ERE-s dhe po ashtu ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar.

2. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar, pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtje si vijon:

“2. Të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “ZAIS”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, për një afat 28-vjeçar.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi